



## POLICIA E KOSOVËS

# “NJIHUNI ME POLICIN E LAGJES TUAJ!”

Policia e Kosovës përpos ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike, zbatimin e ligjit synon të konsolidojë raportet miqësore dhe reciproke të partneritetit me qytetarin, me bashkësinë, me institucionet, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile duke synuar të ruajë dhe të rrisë nivelin e besimit dhe aktivizimit të qytetarit në kërkesa të drejta me qëllim të krijimit të një ambienti pa frikë nga krimi dhe mirëbesimi në mes të publikut dhe policisë.



Parakushti thelbësor i partneritetit polici-qytetar, është pjesëmarrja e qytetarëve në përforcimin e sigurisë dhe në zgjidhjen e problemeve të lidhura me komunitetin. Në mënyrë që të vendoset një partneritet i tillë, policia duhet të përfshihet më mirë në komunitet duke vepruar me pëlqimin e qytetarëve dhe duke përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve.

Policia njih faktin që nuk mundë t'i zgjidhë problemet e sigurisë duke vepruar e vetme, për këtë arsye, ajo nxit partneritetin aktiv me qytetarët dhe bëhet pjesë integrale e bashkësisë dhe e ndihmon atë në përcaktimin e prioriteteve për zgjidhjen e problemeve në një sektor të caktuar patrullues.

## NDËR DETYRAT KRYESORE TË ZYRTARIT TË SEKTORIT POLICOR:

- Krijimi dhe mirëmbajtja e raporteve miqësore me bashkësinë;
- Identifikon dhe adreson brengat e qytetarëve që rrezikojnë sigurinë e bashkësisë në sektor dhe i adreson ato tek eprrorët e policisë;
- Mbanë takime me bashkësinë kur trajtohen problematika të sigurisë në sektor patrullues rreth parandalimit të krimit;
- Bashkëpunon ngusht dhe merr pjesë sipas nevojës me përfaqësuesit e organeve të qeverisjes lokale, përfaqësuesit e bashkësisë fetare, shoqërisë civile, shkollave, mediat dhe të pjesëtarëve të bashkësisë të interesuar për bashkëpunim.
- Në koordinim me strukturat udhëheqëse në stacionin policor, realizon ligjëratat dhe prezantime në shkolla për vetëdijesimin e të rinjve lidhur me dukuritë negative dhe masat parandaluese.

## KARTELA NJIHUNI ME POLICIN TUAJ!



Ofron kontakte mes policisë dhe përfaqësuesve të komunitetit në sektorin përgjegjës për nevojat eventuale që duhet të adresohen për çështje të sigurisë.



## E NJOFTONI POLICIN E SEKTORIT ME PROBLEMET TË CILAT NDËRLIDHËN:

- Veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Në braktisjen e fëmijëve dhe personave të mitur;
- Keqëtrajtimin e fëmijëve dhe personave të pafuqishëm;
- Dëmtimin e pronës private dhe asaj shoqërore;
- Lënien dhe gjetjen e mjeteve eksplozive;
- Dhunën në familje;
- Vendet e rrezikshme (pusetat e hapura)
- Parregullësi të tjera negative në rrethin e juaj.

MOS NGURRONI, NA NDIHMONI PËR JETË ME TË SIGURT DHE MË TË QETË!

POLICIA E KOSOVËS: TEL: 192 DHE APLIKACION: LAJMËRO POLICINË